



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM

Nr 117 Datë 31.10.08

PER

Transferim fondi për NSHP

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës “**Per transferim fondi për NSHP**”, bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr. 9836 dt. 26.11.2007 «Për buxhetin e Shtetit të vitit 2008», Udhëzimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F «Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008», Udhëzimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrisë së Brendshme «Për zbatimin e buxhetit të qeverisjes vendore për vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë» dhe VKB nr 84 dt. 19.09.2008 “Për disa ndryshime në zërat e shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë 2008 mbështetur në kompetencat që ka, mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë transferimin e fondit nga Bashkia tek NSHP për zbatimin e vendimit gjyqësor ndaj znj. Pëllumbesha Shehu me objekt “Lirim dhe dorëzim i sipërfaqes prej 5450m2 truall, shpërblim për përdorimin e kësaj sipërfaqeje dhe heqjen e fidanëve” me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet Bashkia	00	01110	05	Art 6020000	- 200,000
Shtohet NSHP	00	06260	05	Art 6020000	+ 200,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike si dhe Ndërrmarja e Shërbimeve Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase
Raimonda Nase